



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Artan Sulaj** më datën **30.05.2024**, Nr. 318 Regj.Themeltar, ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” vendosur ndaj shtetasit **Artan Sulaj** me vendimin nr.39, datë 14.04.2024 me një masë më të butë si ajo e “arrestit në shtëpi”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, bazuar në nenet 112, 260 të Kodit Procedurës Penale, me vendimin Nr. 318, datë 13.06.2024 vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës nr.318, datë 30.05.2024, të kërkuesit **Artan Sulaj**, nëpërmjet mbrojtëses të tij, me objekt: Zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të caktuar me vendimin nr.39, datë 14.04.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si të pabazuar në ligj dhe në prova.
2. Kundër këtij vendimi lejohet e drejta e ankimit, brenda pesë ditëve duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, me datë 13.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar